



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1873 / Prot.  
6

Tiranë më 25.11.2022

VENDIM

Nr. 33, datë 23.11 2022

***“Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Data Science and Artificial Intelligence”, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, UT, për vitin akademik 2023-2024”***

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, pika 2, gërma b; neni 35, pika 1; neni 38, pika 1, gërma “dh”; neni 80; Udhëzimin e MASR-së Nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL”, Kreu IV, gërma “A”, i ndryshuar, në Statutin e Universitetit të Tiranës neni 31, gërmat f), j) dhe cc); si dhe në propozimin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës me shkresën Nr. 981/1 Prot., datë 22.06.2022, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 23.11.2022;

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Data Science and Artificial Intelligence”, në gjuhën angleze, të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, të UT-së sipas dokumentacionit bashkëngjitur, për vitin akademik 2023-2024.
2. Vendimi i Senatit Akademik t’i përcillet Bordit të Administrimit për veprim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
PROF. DR. ARTAN HOXHA

